LIGJ
Nr. 10 232, datë 11.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I RRUGËS SË MBIKALIMIT TË DURRËSIT""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Saudit për Zhvillim për financimin e projektit "Ndërtimi i rrugës së mbikalimit të Durrësit"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6440, datë 2.3.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MBRETËRIA E ARABISË SAUDITE
FONDI SAUDIT PËR ZHVILLIM

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRTIMI I PROJEKTIT TË RRUGËS SË MBIKALIMIT NË DURRËS
NDËRMJET FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE

HUAJA NR. : /
NËNSHKRUAR MË: 1430 A.H.
QË PËRPUTHET ME: 2009 A.D.

(Projekti përfundimtar pas diskutimeve ndërmjet palëve në Riad nga 4 deri 6.7.2009)

HUAJA NR. : ../…

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e datës 1430 A.H. që përputhet me 2009 A.D.
Ndërmjet:
1) FONDIT SAUDIT PËR ZHVILLIM, Riad, Mbretëria e Arabisë Saudite (këtu quhet Fondi), i përfaqësuar nga SH.T Eng. Yousef Ibrahim AL-bassam, zëvendëskryetar dhe drejtor menaxher ; dhe
2) KËSHILLIT TË MINISTRAVE, (këtu quhet Huamarrësi) i përfaqësuar nga SH.T. ……., Ministër i Financave.

PREAMBUL

A) Ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar Fondit t'i japë një hua për të ndihmuar në financimin e ndërtimit të projektit të rrugës së mbikalimit (Bypass) të Durrësit, të përshkruar në grafikun nr. 2 të kësaj Marrëveshjeje (këtu të quajtur Projekti);

B) Ndërsa Huamarrësi ka marrë nga Fondi i Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab (këtu të quajtur KFAED), një hua në një shumë të barabartë me (6 000 000) dinarë kuvajtianë për të ndihmuar në financimin e fazës së parë të projektit, sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së huasë të lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe KFAED-it (këtu të quajtur Marrëveshja e huasë e KFAED-it);

C) Ndërsa qëllimi i Fondit është ndihmesa për vendet në zhvillim për të zhvilluar ekonomitë e tyre dhe për t'u dhënë atyre huatë e kërkuara për zbatimin e projekteve dhe programeve të zhvillimit të tyre;

D) Ndërsa Fondi është i bindur për rëndësinë e projektit dhe efektet e tij përfituese për zhvillimin ekonomik të popullit paqësor të Shqipërisë; dhe

E) Ndërsa bordi i drejtorëve të Fondit ka rënë dakord, duke pasur parasysh sa më sipër, nëpërmjet rezolutës së tij nr. 11/94/1107 për t'i dhënë Huamarrësit një hua sipas termave dhe kushteve të parashikuara këtu,

prandaj, këto palë, nëpërmjet kësaj, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Kushte të përgjithshme, përkufizime

Seksioni 1.01. Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e huasë të Fondit, të nxjerra me rezolutë të bordit të drejtorëve të fondit nr. 11/14 të datës Rajab 29, 1396 AH që përputhet me 26 korrik 1976 AD, me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përfshirë tërësisht këtu (këto kushte të përgjithshme të zbatueshme për marrëveshjet e huasë të Fondit që këtu quhen kushte të përgjithshme).

Seksioni 1.02. Kur përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, të gjithë termat e përkufizuar në kushtet e përgjithshme dhe në preambulën e kësaj Marrëveshjeje kanë kuptimet përkatëse të parashikuara në të, dhe termi "Ministria" është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve të Huamarrësit.

Neni 2
Huaja

Seksioni 2.01. Fondi bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve në Marrëveshjen e huasë të parashikuara ose të përmendura, një hua në një shumë prej dyzet e pesë milionë (45 000 000) Saudi Riyals.

Seksioni 2.02. Huamarrësi ka të drejtë ta tërheqë shumën nga llogaria e huasë në pajtim me dispozitat e grafikut nr. 1 të kësaj Marrëveshjeje, me ndryshimet e herëpashershme të grafikut me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit dhe në pajtim me procedurat për tërheqjet e fondit saudit për huatë e zhvillimit, për shpenzimet e bëra ose, (nëse Fondi bie dakord) që duhet të bëhen në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për projektin dhe që duhet të financohen nga shumat e huasë.

Seksioni 2.03. Huamarrësi merr përsipër të përdorë shumat e huasë vetëm për financimin e kostos së arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për realizimin e projektit. Prokurimi i këtyre mallrave, punëve dhe shërbimeve është në pajtim me udhëzimet për prokurimin e mallrave dhe kontraktimin për ekzekutimin e punëve dhe përdorimin e konsulentëve të institucioneve të zhvillimit, anëtare të grupit të bashkëpunimit. Huamarrësi merr aprovimin e Fondit para dhënies së

kontratave që duhet të financohen nga shumat e huasë dhe para kryerjes së çdo ndryshimi thelbësor të ardhshëm për secilën prej tyre.

Seksioni 2.04. Data e mbylljes është 31.12.2014 ose një datë e mëvonshme që mund të përcaktohet nga Fondi. Fondi njofton menjëherë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Seksioni 2.05. Huamarrësi paguan një tarifë huaje me një normë dy për qind (2%) në vit mbi shumën principale të huasë së tërhequr dhe që nuk është e shlyer herë pas here.

Seksioni 2.06. Tarifa e huasë dhe detyrimet e tjera paguhen dy herë në vit, më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07. Periudha e huasë është (25) vjet duke përfshirë një periudhë pa interesa prej (5) vjetësh. Huamarrësi shlyen shumën kryesore të huasë në pajtim me grafikun e amortizimit të përcaktuar në grafikun nr.3 të kësaj Marrëveshjeje. Çdo këst paguhet së bashku me detyrimin e huasë dhe detyrime të tjera duke bërë një njoftim (45) ditor që i drejtohet Huamarrësit nga Fondi para datës së kërkueshme.

Neni 3
Ekzekutimi i projektit

Seksioni 3.01. a) Huamarrësi e zbaton projektin, nëpërmjet ministrisë, me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në pajtim me praktikat e përshtatshme administrative, financiare dhe inxhinierike dhe siguron, sapo të jenë të nevojshme, fondet, mjetet, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkohen për zbatimin e projektit.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit (a) të këtij seksioni, Huamarrësi: 1) ofron menjëherë, sapo të jenë të nevojshme, të gjitha fondet e tjera që mund të kërkohen për realizimin e projektit (duke përfshirë çdo fond që mund të kërkohet për të përmbushur çdo rritje në koston e tij përtej kostos së parashikuar në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje; nëse këto shuma janë ofruar nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet Huamarrësit dhe një pale të tretë, termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë të pranueshme për Fondin; 2) bën caktimet e përshtatshme buxhetore vjetore për të përmbushur pjesët e veta të kostos së projektit; dhe 3) mbështet çdo shpenzim tjetër që kalon shumën e huasë dhe që është e nevojshme për arritjen e projektit.

Seksioni 3.02. Huamarrësi i kërkon ministrisë t'i paraqesë Fondit, menjëherë pas përgatitjes, planet, specifikimet, raportet, dokumentet e kontratave dhe grafikët e ndërtimit dhe prokurimit për projektin dhe çdo modifikim të tij ose shtesë me ato hollësi që Fondi i kërkon në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 3.03. Për mbikëqyrjen e ekzekutimit të projektit, Huamarrësi ka inxhinierë konsulentë, kualifikimet dhe eksperiencat e të cilëve janë të pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.04. Në përmbushjen e projektit, Huamarrësi angazhon kontraktues të pranueshëm për Fondin me termat dhe kushtet e pranueshme për Fondin.

Seksioni 3.05. Huamarrësi merr masa që mallrat e importuara që financohen nga shumat e huasë të sigurohen nga rreziqet në lidhje me blerjen, transportin dhe furnizimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit dhe për këtë sigurim çdo kompensim paguhet në një monedhë që është lirisht e përdorshme nga Huamarrësi për të zëvendësuar ose riparuar mallrat.

Seksioni 3.06. Huamarrësi siguron që të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga shumat e huasë të përdoren vetëm për zbatimin e projektit.

Seksioni 3.07. Huamarrësi i kërkon ministrisë që:

a) të mbajë regjistra të përshtatshëm për të regjistruar ecurinë e projektit (duke përfshirë koston e tij), për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumat e huasë dhe për të pasqyruar përdorimin e tyre në projekt dhe për të reflektuar të gjitha operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me projektin;

b) t'u japë të gjithë mundësinë e arsyeshme përfaqësuesve të Fondit për të bërë vizita për qëllimet në lidhje me huanë, të inspektojnë projektin, mallrat dhe shërbimet e financuara nga shumat e huasë dhe çdo regjistër dhe dokument përkatës;

c) t'i japë Fondit të gjithë atë informacion, që Fondi e kërkon në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me projektin, shpenzimin e shumave të huasë dhe mallrat dhe shërbimet e financuara nga këto shuma.

Seksioni 3.08. Huamarrësi i kërkon ministrisë të ndërmarrë të gjitha ato veprime që do të jenë të nevojshme për të përftuar siç dhe kur kërkohet tokë dhe ato të drejta mbi tokën që kërkohen për zbatimin e projektit.

Neni 4
Detyrime të veçanta

Seksioni 4.01. a) Huamarrësi dhe Fondi konfirmojnë pëlqimin e tyre që asnjë detyrim tjetër i jashtëm nuk do të ketë prioritet mbi huanë nëpërmjet një barre të vendosur mbi sendet pasurore qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që, përveç kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse vendoset një barrë në ndonjë send pasuror të Huamarrësit si garanci për një detyrim të jashtëm, kjo barrë garanton *ipso facto* dhe pa shpenzime për Fondin në mënyrë të barabartë dhe të vlerësueshme pagesën e shumës kryesore të huasë, tarifën e huasë dhe çdo detyrim tjetër mbi huanë dhe që në vendosjen e çdo barre të tillë bëhet parashikim shprehimisht për këtë qëllim.

b) Detyrimi i parashikuar në paragrafin (a) të këtij seksioni nuk zbatohet për:

i) çdo barrë të vendosur mbi pasuri, në momentin e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie;

ii) çdo barrë mbi mallrat tregtare për të garantuar një detyrim që maturohet jo më vonë se një vit pas datës në të cilën është shkaktuar fillimisht dhe duhet të paguhet nga shumat e shitjes së këtyre mallrave tregtare; ose

iii) çdo barrë që lind gjatë kryerjes së zakonshme të transaksioneve bankare dhe sigurimit të një detyrimi që maturohet jo më vonë se një vit pas datës së tij.

Seksioni 4.02. Huamarrësi mban ose kërkon të mbahen regjistra të përshtatshëm për të reflektuar në pajtim me praktikat e shëndosha të kontabilitetit, operacionet, burimet dhe shpenzimet, në lidhje me projektin e ministrisë dhe departamenteve të tjera ose agjencive të Huamarrësit, përgjegjëse për zbatimin e projektit ose pjesë të tij.

Seksioni 4.03. Huamarrësi lidh siguracion për projektin për këto rreziqe dhe në ato shuma që janë në pajtim me praktikën e përshtatshme, në përputhje me rregulloren në fuqi në vendin e vet.

Seksioni 4.04. Huamarrësi merr përsipër të bëjë një tabelë kujtese, me dimensione të përshtatshme, të përbërë nga betoni ose metal tjetër të përshtatshëm që duhet të vendoset në një vend të dukshëm në një nga ambientet e përfshira në projekt, për të treguar kontributin e Fondit në financimin e projektit.

Seksioni 4.05. Huamarrësi merr përsipër të sigurojë mirëmbajtjen e përgjithshme duke realizuar inspektimin periodik, në pajtim me principet e përshtatshme inxhinierike dhe për të parashikuar caktimet e nevojshme për këtë qëllim në buxhetin vjetor. Huamarrësi merr përsipër gjithashtu t'i paraqesë Fondit planet e miratuara për mirëmbajtje, siç mund t'i kërkojë Fondi.

Seksioni 4.06. Huamarrësi merr përsipër të kryejë çdo modifikim në projekt vetëm me aprovimin paraprak të Fondit.

Seksioni 4.07. Huamarrësi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që dimensioni dhe ngarkesat me akse të automjeteve që përdorin rrugën, të mos kalojnë kufijtë që respektojnë standardet e projektimit strukturor dhe gjeometrik të rrugës.

Seksioni 4.08. Menjëherë pas përfundimit të projektit, por jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së përfundimit, ose në një datë të mëvonshme që mund të bjerë dakord Fondi për këtë qëllim, Huamarrësi përgatit dhe i paraqet Fondit një raport për përfundimin e projektit, në formë të arsyeshme dhe të detajuar siç e kërkon Fondi, mbi zbatimin dhe operimin fillestar të projektit, shpenzimet e tij dhe përfitimet e përftuara dhe që do të përftohen prej tij, përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas marrëveshjes së huasë dhe arritjen e objektivave të huasë.

Neni 5
Mjetet në dispozicion të Fondit

Seksioni 5.01. Për qëllimet e seksionit 6.02 të kushteve të përgjithshme, ngjarjet e mëposhtme shtesë përcaktohen në pajtim me paragrafin (f) të tij:

a) Në pajtim me nënseksionin (b) të këtij seksioni:

i) e drejta e Huamarrësit për t'i tërhequr shumat e çdo huaje ose granti të dhënë Huamarrësit për financimin e projektit pezullohet, anulohet ose pushohet plotësisht ose pjesërisht, në pajtim me termat e marrëveshjes që e parashikon atë, ose

ii) çdo hua e tillë bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme para maturimit të rënë dakord për të.

b) Nënseksioni (a) i këtij seksioni nuk zbatohet nëse Huamarrësi provon në mënyrë të pranueshme për Fondin që (i) ky pezullim, anulim, pushim ose paramaturim nuk shkaktohet nga mospërmbushja nga ana e Huamarrësit e ndonjë prej detyrimeve të tij, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, dhe (ii) për projektin Huamarrësit i janë vënë në dispozicion fonde të mjaftueshme nga burime të tjera me termat dhe kushtet në pajtim me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Për qëllimet e seksionit 7.01 të kushteve të përgjithshme, ngjarja e mëposhtme përcaktohet në pajtim me paragrafin (d) të tij, d.m.th., që ngjarja e përcaktuar në nënseksionin (a) (ii) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon për një periudhë më të gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data në të cilën Fondi vë në dijeni Huamarrësin për ndodhinë e ngjarjes së sipërpërmendur.

Neni 6
Data e hyrjes në fuqi – Prishja e Marrëveshjes

Seksioni 6.01. Periudha prej (6) muajsh nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7
Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat

Seksioni 7.01. Ministri i Financave të Huamarrësit emërohet si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme përcaktohen për qëllimin e seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme.

PËR FONDIN

Fondi Saudit për Zhvillimin
P.O.Box 50483
Riad 11523
Mbretëria e Arabisë Saudite
Tel:+966-1-2794000
Telefax :+966-1-4647450
E-mail: info@sfd.gov.sa
Swift:

PËR HUAMARRËSIN

1. Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit nr.1
Tirana, Republika e Shqipërisë
Tel: + 35542228405
Telefax:+ 35542228494

2. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Sheshi Skenderbej nr.5
Tirana, Republika e Shqipërisë
Tel: + 35542234647

Telefax : + 35542232389

Në dëshmi të kësaj, këto palë, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit e tyre të autorizuar rregullisht, kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në emrat e tyre përkatës, në qytetin e Tiranës, në ditën, muajin dhe vitin e përmendur më sipër, në dy kopje në gjuhët arabe dhe angleze, secila prej të cilave është një ekzemplar origjinal dhe një kopje e kushteve të përgjithshme në të dy gjuhët që i jepet Huamarrësit. Nëse një dispozitë e versionit arab të Marrëveshjes së Huasë dhe/ose kushteve të përgjithshme është në mospajtim me një dispozitë të versionit në anglisht të Marrëveshjes së Huasë dhe/ose kushteve të përgjithshme, përkatësisht, mbizotëron versioni arab.

PËR FONDIN SAUDIT TË ZHVILLIMIT
Yousef Ibrahim Al-bassam
Zëvendëskryetar dhe drejtor menaxher

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE

GRAFIKU NR.1
TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUASË

A) Tabela e mëposhtme parashikon kategoritë e artikujve që financohen nga shumat e huasë, caktimin e shumës së huasë për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për artikujt që duhet të financohen për çdo kategori.

Kategoria		Shuma e huasë e caktuar (Shprehur në Saudi Riyals)	Përqindje e shpenzimeve që duhet të financohen
1	Ndërtimi i mbikalimit dhe kanalit të kullimit (Pjesa e fazës së dytë të projektit)	40 000 000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
2	Shërbimet e konsulencës dhe mbikëqyrja (Pjesa e fazës së dytë të projektit)	2 000 000	100% e shpenzimeve të përgjithshme
3	Të pacaktuara	3 000 000	
Totali :		45 000 000	

B) Pavarësisht dispozitave të paragrafit (A) të mësipërm, asnjë tërheqje nuk bëhet në lidhje me pagesat e bëra për:

1) Shpenzimet para datës së kësaj Marrëveshjeje;

2) Tatimet e mbledhura nga ose në territorin e Huamarrësit për mallrat ose shërbimet, ose për importimin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre.

C) Pavarësisht nga caktimi i një shume të huasë ose përqindjeve të disbursimit të parashikuar në tabelën e paragrafit (A) të mësipërm, nëse Fondi ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme që shuma e huasë që është caktuar në një kategori do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord për të gjitha shpenzimet e asaj kategorie, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin, mund:

i) të ricaktojë për këtë kategori, në masën që kërkohet për të përmbushur diferencën e parashikuar, shumat e huasë që nuk janë caktuar deri atëherë dhe që, sipas mendimit të Fondit, nuk nevojiten për të mbuluar shpenzime të tjera; dhe

ii) nëse një ricaktim i tillë nuk mund të mbulojë diferencën e parashikuar, të ulë përqindjen e disbursimit që zbatohet për këto shpenzime, me qëllim që të mund të vazhdojnë tërheqjet sipas kësaj kategorie derisa të mbulohen të gjitha shpenzimet e bëra atje.

GRAFIKU NR. 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon të fuqizojë zhvillimin ekonomik dhe social në veri dhe qendër të Shqipërisë duke përmirësuar shërbimet e qarkullimit rrugor për të përmbushur kërkesën në rritje.

Projekti përbëhet nga fazat e mëposhtme:

FAZA E PARË: Ndërtimi i një rruge të re përgjatë rrugës ekzistuese me një gjatësi të përgjithshme prej 5 km; rruga kryesore përbëhet nga dy korsi për secilin drejtim me ishull të brendshëm, rrugët e shërbimit, trotuare, instalimet e mbrojtjes dhe ndriçimit.

FAZA E DYTË: Ndërtimi i përforcimit të mbikalimit prej betoni në Rrethrrotullimin e Durrësit me një gjatësi totale prej 320 m. Edhe ndërtimi i përforcimit të kanalit të kullimit të përforcimit për derdhjen e ujit në të gjithë drejtimin e rrugës me gjatësi prej 1 km, përveç trotuareve dhe instalimeve të ndriçimit; duke përfshirë shërbimet e konsulencës dhe mbikëqyrjes.

E gjithë kostoja e projektit është rreth € (24) milionë që është e barabartë me rreth SR (132) milionë. Projekti pritet të përfundojë në fund të vitit 2013.

GRAFIKU NR.3
GRAFIKU I AMORTIZIMIT

Kësti nr.	Data e pagesës	Shuma e kështit e shprehur në Saudi Riyals
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		
11.		
12.		
13.		
14.		
15.		
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		
22.		
23.		
24.		
25.		
26.		
27.		
28.		

29.		
30.		
31.		
32.		
33.		
34.		
35.		
36.		
37.		
38.		
39.		
40.		
TOTALI		45 000 000